



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

Nr. 1074/2 prot.

Tiranë, më 23 . 10 . 2023

**V E N D I M**

**Nr. 211 , datë 23 . 10 . 2023**

Mbështetur në nenin 32, pika 1, shkronja a), të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>, është paraqitur ankesa nr. 208 Regj., datë 10.10.2023, e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, kundër Këshillit të Qarkut Durrës, me pretendim diskriminimin për shkak të aftësisë së kufizuar.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

**K O N S T A T O I :**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës dhe dokumentacionit bashkëlidhur, rezulton se subjekti ankues, Shoqata Kombëtare “Shpresë për të Verbërit” (Shoqata), është regjistruar si person juridik/organizatë joqeveritare, me seli në Durrës, nëpërmjet Vendimit nr. 6179, datë 07.03.2019 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Sipas shpjegimeve të dhëna, përfaqësuesi i Shoqatës, në mes të tjerash informon se: “*Ne si Shoqatë i jemi drejtuar Këshillit të Qarkut Durrës, që nga krijimi jonë, për të na financuar,*

<sup>1</sup> Në vijim referuar me akronimin LMD.

<sup>2</sup> Në vijim referuar me akronimin KMD ose si Komisioneri.

*bazuar në legjislacionin e parashikuar për financimin e organizatave të aftësisë së kufizuar, për të mundësuar punën e tyre. Kërkesë kjo e trajtuar nga Departamenti i Financës, dhe nga kontaktet tona me këtë Departament, na është bërë me dije se, nga Këshilli i Qarkut është miratuar një fond për Shoqatën tonë dhe na është kërkuar që të paraqesim edhe faturat e shpenzimeve, por deri në këtë moment nuk është hedhur asnjë qindarkë në llogarinë tonë.*

*I jemi drejtuar edhe Kryetarit të Këshillit të Qarkut Durrës, por nuk kemi marrë përgjigje. Kemi vënë re se, organizatat e tjera të aftësive të kufizuara që operojnë në qarkun e Durrësit, kanë marrë financim, ndërsa ne diskriminohemi duke na vështirësuar punën tonë si Shoqatë.”*

Subjekti ankues, Shoqata, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës, dhe ndreqjen e pasojave të ardhura nga diskriminimi i pretenduar.

## **II. Nga shqyrtimi paraprak i ankesës u konstatua se:**

Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, është një organizatë jofitimpurëse, regjistruar si person juridik, me vendimin nr. 6179, datë 07.03.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë. Referuar akteve themeluese, Shoqata ka si qëllim dhe objekt të veprimtarisë së saj mbrojtjen e interesave të anëtarëve të saj të verbër.

Bazuar në ankesën e paraqitur pala ankuese, Shoqata, pretendon se është cenuar në interesin e saj të ligjshëm dhe të drejtpërdrejtë, si person juridik, pasi trajtohet në mënyrë të padrejtë dhe më pak të favorshme, duke mos përfituar financim për ushtrimin e veprimtarisë së saj, sipas përcaktimeve të ligjit nr. 8098, datë 28.03.1996 “Për statusin e të verbërit”, të ndryshuar.

Pala ankuese pretendon se është diskriminuar për sa kohë që dispozitat ligjore nëpërmjet të cilave Shoqata është përfituese në mënyrë të drejtpërdrejtë, nuk zbatohen nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës.

Bazuar në nenin 32, pika 1, shkronja “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, parashikohet:

*“1. Komisioneri ka kompetencë: a) të shqyrtojë ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, siç parashikohet në këtë ligj dhe në ligjin “Për barazinë gjinore në shoqëri” .....”*

Bazuar në nenin 4, të ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku përcaktohen subjektet e ligjit, parashikohet:

*1. Ky ligj zbatohet për të gjithë personat, që jetojnë dhe qëndrojnë në territorin e Republikës së Shqipërisë. 2. Shtetasit shqiptarë, me banim të përkohshëm ose të përhershëm jashtë kufijve të*

*Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare. 3. Personat fizikë e juridikë të huaj, me banim, vendqëndrim apo seli jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, gëzojnë mbrojtjen, që ofron ky ligj, në marrëdhëniet me organet shtetërore shqiptare.”*

Bazuar në nenin 32, pika 3, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “3. Për shqyrtimin e ankesave që i drejtohen, Komisioneri zbaton normat e parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, me përjashtim të procedurave që parashikohen nga ky ligj”.

Bazuar në nenin 3, pika 7 dhe 8, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“Palë” është:

- a) çdo person fizik ose juridik, i cili ka të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pika 1, të këtij Kodi;
- b) një palë që nuk ka një të drejtë ose interes legjitim të drejtpërdrejtë në një procedurë administrative, siç përcaktohet në nenin 33, pikat 2 dhe 3, të këtij Kodi, por që të drejtat ose interesat e saj ligjshëm mund të cenohen nga rezultati i procedurës. ....

Person është çdo person fizik, juridik, si dhe çdo subjekt i së drejtës, sipas legjislacionit në fuqi.”

Referuar nenit 33, pika 1, të Kodit të Procedurave Administrative, përcaktohet se:

“1. Palë në procedurën administrative, përveç sa parashikohet në nenin 3, të këtij Kodi, është çdo person:

- a) me kërkesë të të cilit ka filluar procedura administrative;
- b) ndaj të cilit ka filluar procedura administrative, ose të cilit i drejtohet apo synohet t'i drejtohet vendimi i procedurës administrative;
- c) me të cilin organi publik synon të lidhë apo ka lidhur një kontratë administrative.....”

Bazuar në këto dispozita ligjore, pala ankuese, Shoqata “Shpresë për të Verbërit”, në cilësinë e personit juridik, është subjekt i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe legjitimohet për të paraqitur ankesën objekt shqyrtimi.

Komisioneri gjykon se, në adresimin e kësaj problematike kanë interes legjitim të gjitha organizatat apo subjektet përfaqësuese të personave më aftësi të kufizuara në shikim, të cilat janë të regjistruara në Republikën e Shqipërisë sipas legjislacionit në fuqi dhe kanë si objekt të deklaruar të veprimtarisë mbrojtjen e të drejtave dhe interesave të tyre.

Shkaku i pretenduar nga ankuesi *aftësia e kufizuar*, është shkak i mbrojtur nga neni 1, i ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ku parashikohet se: “Ky ligj rregullon

*zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi përkufizohet nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, në nenin 3, pika 1, si: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të nenit 7, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Mbështetur në detyrimet ligjore të parashikuara në nenin 3 të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë në të cilën shteti merr masa për mbrojtjen e dinjitetit të njeriut dhe respektimin e lirive dhe të drejtave të tij, nenit 14 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ligjin nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi synon respektimin me rigorozitet të parimit të barazisë përpara ligjit, barazi të shanseve dhe mundësive për të ushtruar të drejtat dhe liritë, si dhe zbatimin e efektshëm të politikave antidiskriminuese.

*Nga shqyrtimi paraprak i dokumentacionit të depozituar nga ankuesi pranë KMD-së, Komisioneri konstaton se:*

**A- Lidhur me pretendimin e Shoqatës përsa i takon mosfinancimit të Projekt-Buxhetit të saj për vitin 2021, nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës.**

Nga aktet shkresore të depozituara nga subjekti ankues/Shoqata<sup>3</sup>, rezulton se, pretendimet për veprime diskriminuese nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës, i referohen mosmiratimit të Projekt-Buxhetit të Shoqatës, për vitin 2021, dokument i cili mban datën 26.11.2020.

Po ashtu pretendimi se: *“...nga kontaktet tona, na është bërë me dije se, nga Këshilli i Qarkut është miratuar një fond për Shoqatën tonë dhe na është kërkuar që të paraqesim edhe faturat e shpenzimeve, por deri në këtë moment nuk është hedhur asnjë qindarkë në llogarinë tonë.”*, është thjesht deklarativ dhe i paprovuar në prova e akte shkresore, si dhe i referohet të njëjtit vit, 2021.

Në kërkesën e hartuar nga Shoqata, drejtuar Këshillit të Qarkut Durrës, e cila mban një datë të pa plotësuar dhe pa numër protokoll (shprehimisht: Durrës, më \_\_\_\_\_ 2020), evidentohet se në këtë dokument, ndër të tjera, është hartuar një pasqyrë e detajuar e të gjitha aktiviteteve që Shoqata kishte planifikuar për të realizuar e përmbushur gjatë vitit 2021:

- Aktivitete në kuadër të 8 Marsit;
- Aktivitete në kuadër të 1 Qershorit;
- Aktivitete në kuadër të Ditës së Shkopit të Bardhë;
- Aktivitete në kuadër të 3 Dhjetorit “Ditës Botërore të PAK”;
- Aktivitete në kuadër të 24 Dhjetorit, ditës së themelimit të Shoqatës;
- Aktivitete të ndryshme sportive dhe kulturore;
- Aktivitete bamirësie;
- Aktivitete edukative;
- Aktivitete botuese;
- Aktivitete sensibilizuese (konferenca, seminare, diskutime);
- Trajnime për drejtuesit e Shoqatës;
- Trajnime mbi situatën pandemike;
- Trajnime me drejtues të pushtetit vendor;
- Lidhje marrëveshesh bashkëpunimi me shoqatat homologe dhe organizatat që punojnë me aftësinë e kufizuar brenda dhe jashtë vendit.

Dokumenti/Projekt-Buxheti për vitin 2021, evidenton se:

*“Për vitin 2020 të ardhurat e Shoqatës nga kuotizacionet dhe donacionet janë 110 000 lekë, ndërsa kontributet janë 10 000 lekë, shpenzimet janë 84 000 lekë.*

*Për realizimin e objektivave për vitin 2021, ne kërkojmë financim një fond prej 4 678 4000 lekë, duke paraqitur bashkëlidhur edhe një pasqyrë të detajuar në zëra të posaçëm të shpenzimeve.”*

---

<sup>3</sup> Referuar shkresës me titull “Projekt-Buxheti i Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, Qarku Durrës (Për vitin 2021)”, me datë 26.11.2020, të Shoqatës.

Për sa më sipër, pavarësisht se Shoqata nuk ka depozituar një akt apo shkresë zyrtare sipas kërkesave ligjore (me numër protokollit e datë) të depozituar pranë Këshillit të Qarkut Durrës, referuar dokumentit Projekt-Buxheti për vitin 2021, paraqitur prej saj, Komisioneri merr të mirëqenë faktin se ky dokument, referuar datës që mban (26.11.2020) dhe specifikimeve të tij, është depozituar për t'u miratuar në muajt nëntor-dhjetor 2020, pasi parimisht, projekt-buxhetet që kërkojnë fonde për financim për vitin pasardhës (2021, konkretisht) duhet të depozitohen e analizohen brenda vitit paraardhës, në rastin konkret 2020.

Nëse subjekti ankues do të kishte pasur pretendime lidhur me mosmiratimin e Projekt-Buxhetit 2021, të Shoqatës, kundrejt Këshillit të Qarkut Durrës, marrja dijani e tij lidhur me këto veprime (apo për veprime e mosveprime të tjera diskriminuese të këtij subjekti) i ka lindur që në muajin dhjetor 2020 apo fillim viti 2021, periudhë kur prezumohet të miratohen projektet e paraqitura me qëllim realizimin e përmbushjen e tyre për vitin për të cilin janë parashikuar në Projekt. Kjo edhe për faktin se ky projekt duke qenë nominalisht i projektuar për t'u realizuar në vitin 2021, bëhet i paaplikueshëm dhe i pazbatueshëm për vitin pasardhës, për shkak të specifikave e dinamikave të reja që mund të lindin në vitet pasardhëse, gjë e cila reflektohet në parashikimet e zërat specifike në Projekt-Buxhetin e planifikuar e hartuar vit pas viti.

Pra, subjekti ankues është vënë në dijeni të sjelljes diskriminuese të pretenduar, nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës, lidhur me faktin e mosmiratimit/mosfinancimit të Projekt-Buxhetit 2021, të Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, (*fakt për të cilin dhe pretendon diskriminimin*), që në muajin dhjetor 2020, apo maksimumi fillim viti 2021. Ankesa pranë KMD-së është regjistruar në datën 10.10.2023, pra më vonë se dy vite nga marrja dijani.

Për sa më sipër, referuar nenit 33, pika 4, shkronja dh), të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, i cili citon se “Ankesa nuk prahohet nëse paraqitet më vonë se tre vjet nga ndodhja e diskriminimit ose më vonë se dy vjet nga marrja dijani për sjelljen diskriminuese”, ankesa e Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t'i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj.

Pra, konkludojmë së janë tejkualuar afatet ligjore të përcaktuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, për pranimin e ankesës pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

**B- Lidhur me pretendimin e Shoqatës se Këshilli i Qarkut Durrës nuk i ka kthyer përgjigje shkresës së tyre, lidhur me çështjen e përfitimit të financimeve për ushtrimin e funksioneve e veprimtarisë së saj, Komisioneri vëren se:**

Subjekti ankues/Shoqata është shprehur se ka paraqitur kërkesa drejtuar Këshillit të Qarkut Durrës, për miratimin e fondeve për Shoqatën e tyre dhe nuk kanë marrë asnjë përgjigje prej Institucionit në fjalë.

Lidhur me këtë pretendim të Shoqatës, Komisioneri vëren se, edhe në rastin kur merret e mirëqenë se kërkesa është depozituar pranë Këshillit të Qarkut Durrës, mosveprimi institucional ka të bëjë me moszbatimin e shkeljen e dispozitave ligjore të ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, dhe kjo kërkesë nuk bën pjesë në kompetencat dhe fushën e veprimit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, të përcaktuara shprehimisht në dispozitat e ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar.

Komisioneri vlerëson se, lidhur me pretendimin e Shoqatës, se institucioni sipërcituar, nuk i është përgjigjur kërkesave të saj; autoriteti mbikëqyrës i pavarur për zbatimin e ligjit nr. 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar, është institucioni i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, shqyrton kërkesat e personave, të cilët pretendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre të parashikuara në ligjin 119/2014 “Për të Drejtën e Informimit”, të ndryshuar.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vëren se, marrja në shqyrtim e pretendimit të Shoqatës për moskthim përgjigje nga ana e Këshillit të Qarkut Durrës, nuk bën pjesë në kompetencat e KMD-së, e për pasojë nuk mund të pranohet dhe për rrjedhojë nuk mund t’i nënshtrohet procedurave të mëtejshme të parashikuara në ligj për shqyrtimin e saj<sup>4</sup>.

Në nenin 33, pika 4/b, të Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “4. Ankesa nuk pranohet nëse: b) .....është e papajtueshme me dispozitat e këtij ligji...”.

Në përfundim të shqyrtimit paraprak të ankesës, lidhur me sa sipërcituar, Komisioneri arrin në përfundimin se nuk përmbushen kriteret ligjore për pranimin e ankesës, të përcaktuara nga neni 33, pika 4, shkronja “b”, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, dhe për rrjedhojë kërkimet e subjektit ankues për të shqyrtuar sa më sipër, nuk pranohen.

Për sa më sipër, subjekti ankues mund t’i drejtohet Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, lidhur me pretendimin për cenimin e së drejtës së informimit.

## **PËR KËTO ARSYE:**

---

<sup>4</sup> Për analogji citojmë Vendimin nr. 231, datë 25.11.2021 të KMD-së, Vendimin nr. 256, datë 29.12.2021, të KMD-së, Vendimin nr. 167, datë 22.08.2022, të KMD-së.

Mbështetur në nenin 21/1, nenin 32, pika 1/b, si dhe nenin 33, pikat 2, 4/b/dh, të ligjit nr.10 221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

- 1.** Mospranimin e ankesës së subjektit ankues, Shoqatës Kombëtare “Shpresë për të Verbërit”, pasi nuk plotësohen kriteret përkatëse të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar.
- 2.** Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni e këtij vendimi.

**KOMISIONERI**

**Robert GAJDA**